



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.943/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Milena Đerić kryesues, Rrustem Thaqi dhe Faton Ademi anëtar, duke vendosur përkitazi me apelin e kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Prishtinës Florim Kurti nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur më datë 06.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet i pabazuar apeli Anr.943/2021 i datës 04.11.2021, paraqitur nga kandidati anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Prishtinës Florim Kurti nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë me të cilën ka kërkuar rinumërimin e fletëvotimeve në vendvotimet 1927e/01R, 1927e/04R dhe 1919e/01R.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një apel me datën 04.11.2021 nga e kandidati për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Prishtinës Florim Kurti nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë në të cilën pretendon se në vendvotimin 1927e/01R në shkollën “Shkëndija” në Hajvali, i janë keqpërdorur votat pasi që të njëjtin e kanë votuar 19 anëtar të familjes ndërsa votat nuk i kanë dalë. Gjithashtu pretendon se në vendvotimin 1927e/04R te rubrika me numër 21 ku evidentohen votat e tij ka pas ndërhyrje në të dhe është përmirësuar, gjë që ngjallë dyshime se nuk është paraqitur numri i saktë i votave, ndërsa në vendvotimin 1919e/01R nga FRK-ja e publikuar konstatohet se fillimisht në rubrikën me numër 21 është ndërhyrë duke i shënuar 8 vota e më pas e kanë mbuluar numrin 8 duke ndërhyrë e që ka rezultuar të mos i numërohet asnjë votë.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, dhe në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pa bazuar

Nga shkresat e lëndës, rezulton se nga kandidati anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Prishtinës Florim Kurti nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë me të

cilën ka kërkuar rinumërimin e fletëvotimeve në vendvotimet 1927e/01R, 1927e/04R dhe 1919e/01R.

Paneli, vlerëson se parashtruesi i apelit në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara për mospërputhje të rezultateve, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret paneli, nuk mundi të konstatoj se ka pasur manipulime gjatë numërimit të votave për kandidat të këtij subjekti politik, ashtu siç pretendon ankuesi, për faktin se thëniet e tij nuk mbështetën në asnjë provë konkrete por janë supozime sepse pritjet e ankuesit për të marrë më shumë vota automatikisht nuk nënkupton se ka mospërputhje të rezultatit si dhe llogaritja matematikore nga ana e ankuesit nuk argumenton shkeljet e pretenduara në apel.

Paneli verifikoi provat e ofruara si dëshmi nga apeluasi që ishin Formularët e Përputhjes së të Dhënave dhe Rezultateve nga të cilat formularë për panelin është e qartë se në këto VV kandidati në fjalë ka pas vota dhe të njëjtat vota janë publikuar me rastin e publikimit të rezultatit përfundimtar, por me asnjë provë shkresore ankuesi në VV e vendosur në dispozitiv nuk i ka argumentuar se ka parregullsi me rastin e publikimit të rezultatit apo ka me shumë vota sesa janë publikuar në rezultatin përfundimtar.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr.943/2021 më datën 06.11.2021

Kryesuese e Panelit
Milena Deris



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.